



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 767 / Prot.

Patos, më 18 / 04 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 16 PRILL 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve, Njësia Administrative Zharrëz

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:30

Dëgjese publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv. Kryetari i bashkisë z. Sokol Meta, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e financave znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtore e Urbanistikës znj. Boreta Murati, Drejtore e Projekteve znj. Ermenita Mici, Administrator i Njesisë Zharrëz Z. Riza Hoxha, *rreth 26 pjesëmarrës (kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të banorëve të njësisë Zharrëz etj).*

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për

konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2028”, jemi këtu sot për të dëgjuar të gjitha kërkesat që ka njësia dhe në fund do të merret parasysh secila nga kërkesat tuaja ose jo. Këtu kemi prezent edhe zv/ Kryetarin e bashkisë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

dhe përfaqësues nga drejtoritë e bashkisë.

Do t’ju lutesha që si gjithmonë të respektojmë rregullat e dëgjesës, gjithsecili para se të kërkoj fjalën duhet të prezantohet me emër, mbiemër pasi takimi rregjistrohet dhe çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe mund të vazhdoni të merrni fjalën sipas radhës.

Banor i fshatit të Ri, z. Shaqo Çole– përshëndetje të gjithëve! Është një rrugë që quhet rruga Çole dhe kjo rrugë është më çakull, por është gropëzuar. Ky është problemi i parë që ne



**Banor i fshatit të Ri
z. Shaqo Çole**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

kemi. Problemi i dytë lidhet me kalçeton, pasi unë kam një vëlla të sëmur dhe hidhen topat kur luajnë dhe unë dua të kërkoj brenda mundësive ndonjë rrjet të hollë lart sepse fëmijët kalojnë aty, hedhin dhe topat, por unë kam problemin e vëllait. Unë këtë problem ia kam shtruar edhe Kryetarit të bashkisë dhe kërkoj ndërhyrje nga ana juaj për të zgjidhur këtë problem.

Administrator i Njesisë Zharrëz z. Riza Hoxha- përshëndetje të gjithëve! Ne e kemi parë këtë problem dhe rruga është pjesërisht e gropëzuar dhe në të ardhmen do të ndërhyet. Është rreth 500-600 m rrugë. E kemi dërguar edhe si kërkesë këtë që banor parashtroi.



**Administrator i Njesisë Zharrëz
z. Riza Hoxha**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Banor i njesisë Zharrëz, z. Faslli Hoxha– Unë kam 1 hektar e gjysëm ullishte te kryqi, mirëpo te ajo rruga nuk ngjitet dot mjeti me ngarkesë dhe unë jam më poshtë. Më duhet që të



**Banor i njesisë Zharrëz
z. Faslli Hoxha**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

shkarkoj 150 kunjtal ullinj dhe nuk kam se si unë ta ngjis mjetin atje. Unë kam bërë kërkesë dhe kam folur edhe më para për këtë problem. Problem kam edhe urën, duhet të bëhet dhe ura që të kalohet anës kanalit. Duhet edhe rruga, por edhe ura.

Administrator i njesisë Zharrëz, z. Riza Hoxha- Kjo rrugë është problematike, mirëpo për



**Administrator i njesisë Zharrëz
z. Riza Hoxha**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

pjesën e rrugës kemi dërguar kërkesë në bashki dhe jemi në përgjigje, kurse për pjesën e urës kemi vendosur disa tumbino, por ajo nuk ka kapacitet për të gjitha. Që problematika të zgjidhet duhet të bëhet rruga.

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Novruz Toska- unë kam ngritur disa herë problemin e kanalizimit të ujërave të zëza të Verbasit. Është një investim i lënë përgjysëm, duhet të ishte përfunduar dhe gjysma e investimit që është bërë, është bërë me fondet e komunës. E dyta për Verbasin, kur udhëtojmë në aksin Fier-Berat nuk gjejmë më ndonjë fshat pa trotuar. Është dhe siguri për banorët për të ecur në rrugë nacionale sepse në banojmë aty. Kështu që mendoj



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Novruz Toska**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

që ka ardhur nkoha që Verbasit t'i ndërtohet trotuari si element sigurie për të lëvizur.

Banor i njësisë Zharrëz, z. Besnik Vrapit- unë banoj të lagjja Bahallarëve mbi urë. Kemi një rrugë për të shtruar me gropa që rri ujë komplet. Duhet të kalojnë njerëzit anës mureve që të dalin nga shtëpia. Gjithashtu kemi nevojë për disa kazan mbeturinash pasi i kemi larg. Një person që të shkoj te ura rreth 600 m, zgjedh më shumë të ndot ambientin se sa të shkoj deri te ura për të hedhur mbeturinat.



**Banor i njësisë Zharrëz
z. Besnik Vrapit**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Zv/ Kryetari i bashkisë z. Sokol Meta- Përshendetje! Për pjesën e rrugës, rruga e Bahajve është në planifikim për t'u shtruar me asfalto beton. Për sa i përket mbetjeve do ta rregullojmë dhe atë pjesë. Në momentin që kalon mjeti teknologjik do e sjelli koshin e mbeturinave që mungon.



**Zv/ Kryetari i bashkisë
z. Sokol Meta**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Kryetar i fshatit Belinë z. Agim Grëmbi- Unë kam dy probleme që dua të shtroj. Lidhur me stacionin e pompimit të vaditjes në Belinë, njerëzit tani janë në dilem të mbjellin apo jo



**Kryetar i fshatit Belinë
z. Agim Grëmbi**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

misrin pasi nuk e dinë a do funksionoj apo jo ai stacion, pasi nuk ka përfunduar ende. Problemi tjetër lidhet me ndiçimin në Belinë. Dritat janë djegur të gjitha dhe kanë nevojë të ndërrohen.

Zv/Kryetar i bashkisë z. Sokol Meta- Stacioni i pompimit do të përfundoj së shpejti dhe



**Zv/Kryetar i bashkisë
z. Sokol Meta**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

ndriçimin do të dërgojmë nga Agjencia e Shërbimeve Publike për të rregulluar problemin.

Banor i fshatit të Ri, z. Rexhep Lika – përshendetje! Janë shumë banor që kanë shumë vite



**Banor i fshatit të Ri
z. Rexhep Lika**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

që kanë marrë tokën dhe janë të paazhornuara. Ne taksat i paguajmë të gjithë dhe ende nuk po na jepet një zgjidhje. Kemi edhe një problem të tokat e fushës pasi kanë pastruar mbetjet dhe i kanë hedhur në kanal. Bllokohet kanali dhe tani nuk kalon uji dot më. Duhet pastruar kanalet.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj – është Agjencia Shtetërore e Kadastër ajo që merrret me këto çështje. Nuk është pushteti vendor. Megjithatë ne jemi gjatë gjithë kohës në përpjekje për të ngritur marrëveshje të tilla që do të lehtësojnë këtë problem.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Fermer i fshatit Zharrëz, z. Skënder Toska- unë dua të shpreh një problem lidhur me pemët pasi janë shumë problem. Pemët e shkollës janë shumë keq, kanë insekte, mbushet plot me gjethe dhe ato duhen prerë ose duhen krahasitur të gjitha pemët e rrugës.



Fermer i fshatit Zharrëz, z. Skënder Toska

Dëgjesë publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”

Prill 2025

Banore e fshatit Zharrëz, znj. Idajete Nuraj- Unë kam bërë një kërkesë që në dhjetor. Më ka shkarë uji malit nga lart. Aty ku është kryqi kam 1 ha tokë dhe uji malit ka shkarë. Gjithashtu kam edhe një kërkesë tjetër për rrugën. Rruga të kabina te kryqi të na shtohet pak sepse unë i marr ullinjtë në krah dhe i çoj në shtëpi. Ne nuk kemi rrugë fare aty dhe pak çakull po kërkojmë. Gjithashtu të na shtrohet edhe rruga te lagjja Baha që i thonë këta deri të xhadeja sepse kemi shumë problem atë pjesë për të kaluar. Taksat po i paguajmë të gjitha. Na ndihmoni edhe me pjesën e legalizimeve sepse jemi duke u përpjekur shumë për ato procedura.



**Banore e fshatit Zharrëz
znj. Idajete Nuraj**

Dëgjesë publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”

Prill 2025

Administrator i njësisë Zharrëz, z. Riza Hoxha- Për sa i përket kërkesës së znj. Nuraj ne kemi pasur 2 kërkesa, një për vitin 2024 dhe është realizuar dhe një kërkesë për vitin 2025 që bëhet fjalë për rrugën e tokës e cila është rreth 2 km dhe kërkohet një investim dhe rruga tjetër ku ka shtëpinë edhe zonja është në proces për të filluar për tu sistemuar nga Bankers dhe do të filloj së shpejti.



**Administrator i njësisë Zharrëz
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Kryetar i fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- përshëndetje! Rruga e Ferranjakëve po bën 10 vjet që ka filluar si rrugë. Kur do të përfundoj ajo rrugë.



**Kryetar i fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Drejtores e Urbanistikës dhe Planifikimit Urban, znj. Boreta Murati- Rruga e Ferranjakëve këtë vit do të bëhet dhe do të shtrohet me asfalto beton. Në këtë rrugë para disa vitesh është bërë KUZ dhe është shtruar me akull. Tani do të karikohet me çakull. Do të shtrihet me stabilizant dhe më pas me asfalto beton. Gjithashtu do të pastrohen edhe kanalet anësor. Ka edhe një projekt të miratuar dhe një kontrat për këtë rrugë.



**Drejtores e Urbanistikës dhe Planifikimit
Urban,
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Banor i fshatit Zharrëz, z. Shaban Dimollari – përshëndetje! Lidhur me pjesën e



**Banor i fshatit Zharrëz
z. Shaban Dimollari**

Dëgjese publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

subvencionimin e naftës unë shikoj që ka shumë burokracira. Kërkohet planvendosja, paguhet tarifa, këto janë elementë që nuk kanë qenë vitet e tjerë.

Drejtores Urbanistikës dhe Planifikimit Urban, znj. Boreta Murati- Ka dal një udhëzim i ri që thotë që për secilin nga kryefamiljarët e familjes bujqësore që ka një AMTP apo certifikatë pronësie duhet një planvendosje dhe për këtë ju duhet të paraqiteni në njësi ose në bashki të pajiseni me një planvendosje.



**Drejtores Urbanistikës dhe
Planifikimit Urban,
znj. Boreta Murati**

Dëgjese publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Drejtores Urbanistikës dhe Planifikimit Urban, znj. Boreta Murati- Ka dal një udhëzim i ri që thotë që për secilin nga kryefamiljarët e familjes bujqësore që ka një AMTP apo certifikatë pronësie duhet një planvendosje dhe për këtë ju duhet të paraqiteni në njësi ose në bashki të pajiseni me një planvendosje. Edhe me pjesën e aplikimeve për skemën do të keni asistim nga ana e bashkisë Patos.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni ndonjë kërkesë tjetër kundrejt bashkisë unë do ta deklaroja të mbyllyr këtë dëgjese publike. Ju falenderoj për prezencën tuaj dhe gjithë kërkesat e bëra kundrejt bashkisë Patos.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak, z.
Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba





